



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë,02.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “EJONA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës”, me Nr. të Prok: 616 20 082 521 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “EJONA” të dt. 01.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës”, me 616 20 082 521 kundër Njoftimit për KONTRATE të AK –së, të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “EJONA” me datë 01.07.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës” me Nr. të Prok: Nr 616 20 082 521 . Autoriteti Kontraktues, me datë 01.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Lidhur me pretendimin tuaj për përkrahjet jo të duhura për ashensorin dhe pjesët ju sqarojmë se kjo ka të bëjë me Njesinë eKërkesës dhe jo si që pretendoni ju me Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit.Poashtu paraqitja e cmimeve për pjesë apo në total për ashensorin nuk paraqet asnjë shkelje pasi që Autoritetit Kontraktues kjo i jep oferte të detajuara,ndërsa besoj se as për tenderuesit nuk paraqet problem,pasiqë në vlerësim llogaritet cmimi total;

-Pretendimi tjetër është i pa definuar pasi që pretendoni se përshkrimi i dhënë i përshtatet vetëm një prodhuesi dhe atë të kualitetit me të ulët, por nuk keni çekur as brendin as prodhuesin dhe këtë nuk mund ta trajtojmë pa informtat e tilla;

-Lidhur me stafin profesional ju sqarojmë se kjo është bërë në harmoni dhe konsultim me njesinë e kërkesës dhe Departamenti i Prokurimit nuk mund ta rivedinojë këtë pjesë të kërkesave;

-Lidhur me pretendimin se është e pakuptueshme kërkesa në KVK për mbajtjen e parase për periudhën garantuuese, ju sqarojmë se kjo nuk duhet të ju paraqesë shqetësim pasi që me të gjitha dispozitat ligjore mbajtja e parase mund të zëvendësohet me sigurimin e ekzekutimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit